



NJOFTIMI I TRETË PUBLIK

Siç është njoftuar edhe më parë, Agjencioni Kosovar për Prona (“AKP”) është formuar me 4 Mars 2006 sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/10. Është agjencion i pavarur që ka mandatin për të rizgjedhur kërkesat për pronat e patundshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale që rrjedhin nga konflikti i vitit 1999.

1. Pranimi i Kërkesave në Serbi fillon me 3 Korrik 2006

AKP do të filloj të pranoj kërkesat në zyrën në Beograd të Hënën me 3 Korrik 2006. Ju lutem, informohuni se kërkesat mund të paraqiten nga çdo person fizik apo juridik në zyrat e AKP-së që gjenden në:

KPA (AKP) Beograd

Kosovska 49/8

Tel: 011 334 5513 or 224 5314

Fax: 011 334 4452

AKP aktualisht po aranzhon lehtësimin e pranimit të kërkesave në pjesët tjera të territorit të Serbisë, Malit të Zi dhe IRFJM-së dhe së shpejti do ti publikojmë detajet mbi zyrat tjera të pranimit të kërkesave.

KPA (AKP) Gjilan

Rade Popovic/Washington Street

Tel: 0280 20 289 - fax: 0280 24 067

KPA (AKP) Mitrovicë

Pjesa jugore: Rr. Mbretëresha Teuta (përballë Jugobankës)

028 30 136 dhe 30137 - fax: 028 30 139

Pjesa veriore: Filipa Visnjica Nr. 4, Dhoma Nr. 18 (ish Ndërtesa e KTA-së), Shtojca e Stacionit të Veriut

Tel: 063 197 6470 - fax: 028 30 139

KPA (AKP) Pejë

Rruga Bill Clinton, Nr. 54

Tel: 039 32 968 - fax: 039 32 968

KPA (AKP) Prishtinë

Qendra e qytetit: Rexhep Luci 28/ Rruga e Goleshit 2

Tel: 038 225 473 - fax: 038 249 919

Graçanicë /Gracanica: Pas ndërtesës së Komunës

Tel: 038 225 473

KPA (AKP) Prizren

Jeronim Derada (ish Zef Mark Lushi/Metohis) Nr. 63/A

Tel: 038 504 604 8046 - fax: 029 631 429

2. Adresa elektronike e AKP-së

Adresa elektronike e AKP-së është www.kpaonline.org ku mund të gjeni informata se si mund të paraqitni kërkesë në agjencion, mandatin e tij dhe ligjet që do të aplikohen në procedurën dhe rizgjedhjen e kërkesave, përveç në kohën përkatëse për statistikat dhe statutin e kërkesave individuale.

3. Mundësia e rekrutimit

AKP ka filluar mundësin e rekrutimit në të dhe ftojmë në aplikim për të gjitha postet e proklamuar në adresën tonë elektronike www.kpaonline.org. Njoftimi i parë është publikuar në këtë adresë: <http://www.kpaonline.org/PDFs/060619%20KPA%20Ad-01%20SC.pdf> – dhe ju lutem njoftohuni se afati i fundit është 4 Korriku 2006. Njoftimi i dytë pritet gjatë fundit të muajit Korrik.

4. Raporti vjetor i DCBP-së për vitin 2005

DCBP ka publikuar gjatë kësaj jave raportin e vet vjetor për vitin 2005. Raporti prezanton tregimet e nëntë Paraqitësve të kërkesave, së bashku me skicën e aktiviteteve dhe të arriturave të institucionit për periudhën gjer në Dhjetor 2005. Statistikat relevante mbi vendimet dhe zbatimet e kërkesave përfshihen në broshurën e ndarë. Ju mund të zbrazeni versionin elektronik të pjesës së parë të raportit (të nëntë tregimet) në këtë adresë:

<http://www.kpaonline.org/media/LocalAnnual.exe> (në gjuhën lokale); dhe

<http://www.kpaonline.org/media/EnglishAnnual.exe> (në gjuhën Angleze).

Informatat mbi statistikat janë të mundura në këtë adresë (aktualisht vetëm në gjuhën Angleze): **XX**

5. Caktimi i Anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës të AKP-së

Agjencioni Kosovar për Prona është i përbërë nga Bordi Mbikëqyrës, Sekretariati Ekzekutiv dhe Komisioni i Kërkesave për Prona. Sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, funksioni i Bordit Mbikëqyrës është mbikëqyrja e punës së AKP-së dhe të ofroj përkrahje administrative, direktiva të përgjithshme dhe udhëheqje të rregullores. Bordi përbëhet nga 5 anëtarë, njëri nga të cilët është i caktuar si Kryetar. Me 29 Qershor, PSSP në pajtim me autoritetin që ka dhe sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, ka caktuar 5 anëtarët e Bordit si në vijim (Kryetari është radhitur i pari, ndërsa të tjerët sipas alfabetit):

Mr. Steven Schook, Kryetar;

Mr. Carel Brands;

Mr. Ardian Gjini;

Mr. Kirk McBride; dhe

Mr. Milorad Todorovic.